



“SHTATË” mbërrin në Shqipëri në 8 Nëntor

E konceptuar si një tur që do të udhëtojë në 6 shtete të Ballkanit, Bosnje-Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Maqedoni dhe Serbi, “SHTATË” do të ngre siparin për herë të parë edhe në Shqipëri në datë 8 Nëntor 2013.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), një organizatë jofitimprurëse shqiptare, që ofron shërbim ligjor falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore, në bashkëpunim të ngushtë me Ambasadën Suedeze në Tiranë, Civil Rights Defenders, Hedda Production AB dhe mbështetjen e Institutit Suedez, po organizojnë shfaqjen “SHTATË” në Shqipëri.

“SHTATË” është një shfaqje dokumentare e krijuar në vitin 2007 bazuar në intervistat me shtatë gratë aktiviste të të drejtave të grave nga e gjithë bota, përkatësisht nga Guatemala, Irlanda Veriore, Rusia, Nigeria, Afganistani, Pakistani dhe Kamboxhia. Shtatë gratë që portretizohen në këtë shfaqje luftojnë për të drejtat e tyre por edhe për të drejtat e njerëzve të tjerë.

“SHTATË” ka arritur të mbledhë së bashku në një skenë një ansambël unik aktorësh si politikanë, zyrtarë qeveritarë, aktorë, figura publike dhe aktivistë, femra dhe meshkuj për të portretizuar shtatë gratë në shfaqje. Në fjalën e mbajtur nga Hillary Clinton, Sekretarja Amerikane e Shtetit thekson:

“Shfaqja portretizon fuqishëm rrugën e shndërrimit të shtatë grave të guximshme të cilat kanë ndryshuar shoqërinë e tyre për më mirë - nga vendosja e paqes, lufta kundër korrupsionit, tek lufta e dhunës ndaj gruas.”

Një nga qëllimet specifike të Turit Ballkanik të “SHTATË-s” për vitin 2013 është që të krijojë një debat të gjerë publik mbi dhunën me bazë gjinore dhe të drejtat e grave duke përfshirë median, vendimmarrësit, opinionistët, publikun e gjerë dhe individë të të gjitha gjinive.

Duke patur parasysh numrin e lartë të grave që vriten në Shqipëri si viktimat e dhunës në familje, apo disa qindra të tjera që janë viktimat e dhunës fizike dhe psikologjike dhe duke patur parasyshse statusi i grave në shoqëri nuk është i barabartë me atë të burrave, përmes “SHTATË-ës” ne duam të arrijmë këto qëllime:

1. Të rrisim ndjeshmërinë e shoqërisë mbi fenomenin e dhunës në familje si një formë e dhunës me bazë gjinore.
2. Të rrisim ndjeshmërinë e vendimmarrësve mbi fenomenin e dhunës në familje si një formë e dhunës me bazë gjinore dhe njëkohësisht, të rrisim përgjegjësitë e tyre në drejtim

- të çështjeve të të drejtave të grave;
3. Të rrisim rolin e medias në mënyrë që ajo të theksojë shqetësimet rreth këtij fenomeni, të zgjerojë diskutimet e tij në nivele më të gjera dhe të rrisë ndërgjegjësimin mbi këtë fenomen;
 4. Të forcojmë besimin e target grupit të grave dhe vajzave të dhunuara.

Shtatë figura të shquara shqiptare nga politika, media, teatri dhe sporti janë ftuar të jenë pjesë e ansamblit të “SHTATË”.

Për më shumë informacion rreth këtij projekti, vizitoni faqen

www.sevenwomen.se/en